



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:142176

Datë: 12.02.2024

Numri i dokumentit: 05312196

AA.nr.252/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit I.G, nga Podujeva, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës-Policia e Kosovës, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1766/2022, të datës 06.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 07.02.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit I.G, nga Podujeva, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1766/2022, i datës 06.02.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1766/2022, të datës 06.02.2023, është refuzuar si e pabazuar, kërkesëpadia e paditësit I.G, nga Podujeva, me të cilën ka kërkuar nga gjykata, që të anulohet vendimin e të paditurës Komisionit për Ankesa dhe Shpërblime nr.122-KA-D/2015, të datës 08.07.2015.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjorë ka ushtruar ankesë paditësi për shkak të: shkeljes së dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, ashtu siç rrjedh nga përmbajtja e ankesës. Me propozim që ankesa e paditësit të miratohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të kundërshtuar në pajtim me nenin 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me dt.21.07.2015, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi, e cila është pranuar nga Departamenti i Përgjithshëm/ Divizioni Civil dhe ky divizioni më pas me vendimin C.nr.1691/15 të datë 25.02.2019 është shpallur jokompetent dhe kjo lëndën më pas më datë 13.07.2022 është pranuar për trajtim në Departamentin për Cështje Administrative. Kështu për të vendosur lidhur me të gjykata e shkallës së parë ka caktuar seance të shqyrtimit kryesor me dt 06.02.2023, e cila është mbajtur konform nenit 38 paragrafi 5 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) në prezencën e paditësit dhe në mungesën e palës së paditur.

Gjykata e shkallës së parë, pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar nr.122-KA-D/2015, të datës 08.07.2015, dhe pas administrimit të provave, si në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar duke lenë në fuqi vendimin e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës - Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave. Me arsyetim se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të goditur me padi, në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar. Me aktvendimin e të paditurës, nr.122-KA-D/2015, të dt.08.07.2015, të goditur me padi, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit e paraqitur, ashtu që vendimi i nivelit lokal- Stacioni Policor Veriu me nr.MDNL-PR-0152, i dt.25.06.2015, me të cilin punonjësi i policisë toger N.L shpallet i pafajshëm. I pakënaqur me këtë aktvendim paditësi ka parashtruar padi, dhe për të vlerësuar ligjshmërinë e tij gjykata e shkallës së parë, i'u referua: **UDHËZIMIT ADMINISTRATIV Nr.06/2012, PËR SHKELJET MASAT DHE PROCEDURËN DISIPLINORE NË POLICINË E KOSOVËS**, i cili në: nenin 26, dhe 30 të tij ka përmenduar ndër të tjera arsyet bazë për shqiptimin e masave disiplinore. Përveç referimeve ligjore të cekura më lartë, gjykata e shkallës së parë iu referua dhe mori për bazë edhe provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe kështu nga provat e prezantuar vërehet se: paditësi kishte paraqitur ankesë në Inspektoratin e Policisë, ndaj punonjësit policor Toger N.L, i ngarkuar me punë në stacionin policor Veriu në Prishtinë. Kjo ankesë nga ana e Inspektoratit Policor dhe Drejtorisë së Standardëve Profesionale, me datë 02/06/2015 ishte adresuar për shqyrtim dhe hetim në nivel lokal, me dyshimin se punonjësi në fjalë ka kryer shkelje disiplinore nga neni 26 pika 1.6 dhe 30 pika 1.4 të Udhëzimit Administrativ nr.06/2012. Kështu me qëllim të vërtetimit nëse punonjësi i policisë ka kryer shkeljet e cekura, nga provat e prezantuara nga e paditura, bëhet ditur se ish kryer një varg veprimesh hetimore, kështu janë dëgjuar dëshmitar/zyrtar policor, është dëgjuar ankuesi dhe vetë punonjësi policor kundër të cilët është parashtruar ankesa, dhe mbi bazën e gjitha këtyre ishte përpiluar edhe Raporti përfundimtar i hetimeve ref:MDNL-PR-0152 i datës 24.06.2015. Kështu nga të gjitha këto dëshmi dhe prova është konstatuar se me datë 13.05.2015 një patrullë e stacionit policor veriu kishte reaguar në bazë të informatës së pranuar lidhur me një tentim vetëvrasje, dhe është vërtetuar se në pyetje ishte paditësi I.G, i cili po më këtë datë është sjellë edhe në Stacion Policor. Për gjykatën e shkallës së parë u bë e ditur se pala paditëse ditën e cekur kishte pasur problem shëndetësore dhe nuk ishte në gjendje që të zhvillohej ndonjë intervistë me të në stacionin policor, mirëpo me asnjë nga deklaratat e dëshmitarëve nuk u vërtetua se toger N.L i cili punonte në atë stacion ka pasur sjellje jo të mira me qytetarin/paditësin I.G. Prandaj, duke qenë se nga gjykata e shkallës së parë nuk u vërtetua se punonjësi policor ka kryer ndonjë shkelje që përbën bazë për shqiptimin e masës disiplinore, gjykata e shkallës së parë vlerëson se e paditura MPB drejtë ka vendosur kur ka marr vendimin me të cilin ishte refuzuar ankesa e paditësit dhe kishte mbetur në fuqi vendimin nr.MDNL-PR-0152, me të cilën zyrtari policor N.L ishte shpallur i pafajshëm, pasi që për zyrtarin në fjalë nuk ishte konstatuar se kishte vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura apo me detyrat dhe përgjegjësit e tij prej zyrtari. Gjykata

e shkallës së parë, po ashtu ka vlerësuar edhe pretendimet e paditësit të dhëna në padi dhe në seancë kryesore, por të njëjtat i refuzoi si të pabazuara, ngase me asnjë provë të vetme, nuk i ka provuar të njëjtat pretendime. Prandaj, si përfundim gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se në këtë çështje administrative, nga i padituri drejtë është vërtetuar gjendja faktike, drejtë janë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative dhe të ligjit material, kur është vendosur si në vendimin lidhur me të cilin është hapur konflikti.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 9 dhe 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, ka dhënë arsye të mjaftuara bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike.

Gjykata e Apelit, aktgjykimin e ankimuar e ka shikuar edhe sipas detyrës zyrtare për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës. Meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave esenciale të dispozitave të procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa, sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se në procedurën disiplinore ishin dëgjuar dëshmitarë- kolegë të zyrtarit policorë të paraqitur andaj edhe nuk ishte realisht e pritshme se kolegët do të dëshmojnë kundër zyrtarit të paraqitur dhe do ta mbështetnin ankesën e qytetarit dhe gjykata e shkallës së parë ia falë besimin gjendjes së tillë faktike duke vlerësuar gabimisht se gjykata nuk u bind se zyrtari policor kishte kryer shkelje që përbën bazë për masë disiplinore. Ti thuash qytetarit le të cofë nga zyrtari i cili duhet të kujdeset për sigurinë e çdo qytetari është e rëndë, me këtë rast paditësi nuk ngul këmbë se vetëm çka thotë ky është e vërtetë, po si komisioni ashtu edhe gjykata do të duhet që me rezervë të vlerësonin gjendjen faktike kur e njëjta është vërtetuar vetëm nga dëshmitarët që ishin kolegë të paraqiturit. Rikujtojmë se paditësi është i sëmur me çrregullim të rëndë mendor, këtë konstatim e kanë dhënë ekspertët, është çrregullim kronik afatgjatë me rrjedhë episodike me përmirësime dhe përkeqësime të gjendjes së tij, ka nevojë për përkujdesje nga personi tjetër, duke marrë për bazë faktin nuk e kishte të zgjidhur çështjen e strehimit, pasurinë në fshat i kishin marrë vëllezërit, ishte i detyruar të strehohej në një lokal në Podujevë, kjo krizë mendore e kishte shtyrë që ditën kritike të tentoj të vetëvritet. Kolegji i kësaj gjykata vlerëson se këto pretendime ankimore janë të pa bazuara sepse gjykata e shkallës së parë, me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit në padi janë të pabazuara, për faktin se të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës, është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sepse i njëjti është marrë pas vërtetimit të gjitha fakteve relevante dhe është bazuar në Ligjin për Policinë e Kosovës dhe në Udhëzimin Administrativ 06/2012, meqë me vendimin e komisionit të brendshëm disiplinor janë pushuar hetimet disiplinore për shkak se pas vlerësimit të të gjitha provave dhe dëshmi nuk është arritur të provohet se punonjësi i policisë së Kosovës ka kryer shkelje disiplinore.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të përsëritura të paditësit, por të njëjtat nuk i ka aprovuar për faktin se të njëjtat janë të paargumentuara për vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga organi i paditur, dhe nga gjykata e shkallës së parë. Ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsyet e mjaftueshme mbi faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të padisë së paditësit, dhe lënies në fuqi të vendimit të kontestuar, e pasi që me pretendimet ankimore një aktgjykim i tillë nuk mundë të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr.252/2023, me datë 07.02.2024

Kryetari i Kolegjit,
Ramiz Kuqi